



## НДËРМАРРЈА ПУБЛИКЕ Е РРУГËВЕ СШТЕТËРОРЕ

ПРОГРАМИ ЈАВОР ПËР НДËРТИМИН, РИНДËРТИМИН, РЕХАБИЛИТИМИН,  
МИРËМБАЈТЈЕН ДНЕ МБРОЈТЈЕН Е РРУГËВЕ СШТЕТËРОРЕ ПËР ВИТИН  
2021



Në bazë të nenit 19 të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19) dhe nenit 20 të Statutit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, Këshilli Drejtues miratoi Programin vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2021:

## HYRJE

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore është themeluar më 3.1.2013 me Vendim për themelim nr. 41-10147 / 1 datë 28.12.2012, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 1 datë 2.1.2013. Ndërmarrja Publike është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër NVA 6839673 dhe e njëjta është pasardhëse ligjore i Agjencisë së Rrugëve Shtetërore Shkup.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore e organizon punën e saj, planifikimin, zhvillimin dhe sigurimin e të hyrave në bazë të Programit vjetor për ndërtim, rindërtim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore.

## I.

### TË HYRAT E PLANIFIKUARA DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA TË NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE PËR VITIN 2021

Të hyrat e planifikuara për vitin 2021 përfshijnë me ligj burimet e parapara të financimit për kryerjen e veprimtarisë themelore të ndërmarrjes, të përcaktuara sipas Ligjin të Rrugëve Publike, edhe atë:

- 1) pjesë të akcizës ndaj derivateve të naftës;
- 2) kompensim për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore);
- 3) kompensim për përdorimin e rrugës publike, një pjesë ose e objektit në rrugë (taksa rrugore);
- 4) kompensim për:
  - a) vendosja e mbishkrimeve dhe të tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
  - b) lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
  - c) vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe në mbrojtëse të rrugës shtetërore,
  - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
  - d) përdorimi i tepruar i rrugës,
  - dh) transport i jashtëzakonshëm dhe
  - e) dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore;
- 5) mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) hua dhe kreditë dhe
- 7) të hyra të tjera

Shuma e mjeteve nga pika 1 përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e njëjta nuk mund të jetë më pak se 20% e të ardhurave të përgjithshme në bazë të akcizës nga derivatet e naftës. Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në llogarinë e Ndërmarrjes publike të paktën 4 herë në vit, në interval prej të paktën 3 muajve kalendarik.

- Ilustrim tabelor i të ardhurave të planifikuara dhe të hyrave nga kreditë e huaja për vitin 2021

TË HYRAT DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA	PROGRAMI I VITIT 2021
<b>TË HYRAT</b>	<b>10,293,000,000</b>
1. Pjesë e akcizës nga derivatet e naftës	4,650,000,000
2. Taksa rrugore	3,550,000,000
3. Regjistrimi (taksa rrugore nga regjistrimi)	2,050,000,000
4. Të hyrat tjera nga puna	43,000,000
<b>TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA</b>	<b>12,538,500,000</b>
1. Kredi nga Banka Botërore	754,000,000
2. Kredi nga BERZH-I	8,784,500,000
3. Kredi nga banka Eksim	3,000,000,000
Mjete të transferuara nga buxheti i vitit 2020 me Vendim të Qeverisë	180,000,000
<b>GJITHSEJ</b>	<b>23,011,500,000</b>

I.1 Në vitin 2021 planifikohet të realizohen të hyra prej **10.293.000.000 denarëve**, siç vijon:

I.1.1 Planifikohet të rriten të hyrat e akcizës krahasuar me vitin e kaluar për shkak të rritjes së pritur të përqindjes së pjesës së akcizës që transferohet në NP e Rrugëve Shtetërore, si pasojë të hyrat e akcizës nga derivatet e naftës për vitin 2021 planifikohen të jenë **4.650.000.000 denarë**.

I.1.2 Nga kompensimi për përdorimin e rrugës publike, pjesës së saj ose objektit të rrugës (taksa rrugore), priten të hyra prej **3.550.000.000 denarë**. Të hyrat e përgjithshme mbi këtë bazë llogariten sipas frekuencës së realizuar të trafikut sipas llojeve dhe kategorive të automjeteve në vitin 2020 dhe të hyrave të realizuara nga vitet e mëparshme dhe në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e mbledhjes së kompensimit për përdorimin e rrugës (taksës rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/19). Këto të ardhura janë rritur në krahasim me vitin 2020 dhe vitet e mëparshme


pasi më 28.10.2020 u hap stacion i ri i taksës rrugore në Demir Kapi, ndërkaq deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2021 pritet që dy stacione të reja të taksës rrugore të lëshohen në përdorim në magjistralen Milladinoc- Shtip.

I.1.3 Të hyrat e planifikuara nga kompensimi për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) që paguhet gjatë regjistrimit të automjeteve, janë **2,050,000,000 denarë**. Të hyrat janë planifikuar dhe realizohen në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/09) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për shumën dhe mënyrën e pagimit të kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/14), si dhe në bazë të të ardhurave të realizuara nga vitet paraprake mbi këtë bazë.

I.1.4 Të hyrat e tjera nga puna në vitin 2021 pritet të jenë 43,000,000 denarë, ndërkaq planifikohet të realizohen nga kompensimet që paguhen rrugët magjistrale dhe ato rajonale, ose:

- vendosja e mbishkrimeve dhe e tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
- lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
- vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtës të rrugës shtetërore,
- ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
- përdorimi i tepruar i rrugës,
- transport i jashtëzakonshëm
- dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore;

I.1.5 Ilustrim grafik i të hyrave të planifikuara për vitin 2021




**I.2** Në vitin 2021 planifikohet të realizohen të ardhura nga kredi të huaja në vlerë të përgjithshme prej 12.538.500.000 denarëve, nga:

**I.2.1** Nga Banka Botërore, për financim të projekteve priten të ardhura prej 754.000.000 denarëve,

**I.2.2** Nga Banka Europiane e Rindërtimit dhe e Zhvillimit priten të ardhura prej 8.784.500.000 denarëve,

**I.2.3** Nga Banka Eksim, për vitin 2021 planifikohet të tërhiqen mjete prej 3.000.000.000 denarëve.

**I.2.4** Ilustrim grafik i të ardhurave të planifikuara nga kredi të huaja për vitin 2021



I.3 Në bazë të Vendimit për miratimin e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 nr. 11754/13 datë 11.12.2020 dhe Vendimit për ndryshimin e Vendimit për miratimin e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 nr. 44-12415/2 datë 22.12.2020, janë miratuar mjete në vlerë prej 180,000,000 denarë për NP-në e Rrugëve Shtetërore, të destinuara për furnizimin me mekanizma për mirëmbajtjen e standardeve minimale të infrastrukturës së NP-së për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale. Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 në fund të vitit në llogari me qëllim të veçantë të NP-së së Rrugëve Shtetërore dhe transferohen në vitin 2021, ndërkaq do të përdoren me qëllim sipas Vendimit.

## II.

### SHPENZIME TË PLANIFIKUARA, SHLYERJE TË KREDIVE DHE PROGRAMI I INVESTIMIT I NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE PËR VITIN 2021

Në vitin 2021, për investime, shlyerje të kredive dhe shpenzime, planifikohen mjete prej **23.011.500.000 denarë**.


- Ilustrim tabelor për investimet e planifikuara, shlyerjen e kredive dhe të shpenzime për vitin 2021

<b>SHPENZIME, SHLYERJE TË KREDIVE DHE I INVESTIME</b>	<b>23,011,500,000</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,451,000,000</b>
1. Shpenzime për materiale harxhuese të zyrës, inventar i imët dhe karburant	20,000,000
2. Shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve, shërbime komunale dhe shërbime të tjera	1,452,000,000
3. Paga dhe shtesa të tjera për punonjësit	300,000,000
4. Transferim drejt NVL-ve për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave	300,000,000
5. Taksa, kthim të mjeteve nga regjistrimi, provizione bankare dhe shpenzime të tjera nga puna	379,000,000
<b>SHLYERJA E NORMËS SË INTERESIT DHE KRYEGJËSË NGA KREDITË E MARRA</b>	<b>4,550,000,000</b>
1. Shlyerja e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	830,000,000
2. Shlyerja e kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	3,720,000,000
<b>PROGRAMI I INVESTIMEVE</b>	<b>16,010,500,000</b>
1. INVESTIME NGA MJETET VETJAKE DHE MJETET E BUXHETIT	3,472,000,000



<b>1.1 Ndërtim dhe rehabilitim të rrugëve, ndriçim, sinjalizim, ura, tunele, rrëshqitje të tokës dhe pjesëmarrje vetjake në investime nga kreditë e huaja</b>	<b>1,642,000,000</b>
1.1.1 Ndërtim dhe rehabilitim të rrugëve	1,075,000,000
1.1.2 Ndriçim dhe sinjalizim	10,000,000
1.1.3 Rrëshqitje të tokës dhe rehabilitim të urave dhe tuneleve, e punime të tjera	235,000,000
1.1.4 Pjesëmarrje vetjake në investime me kredi të huaja	322,000,000
<b>1.2. Mirëmbajtje investuese të rrugës</b>	<b>726,000,000</b>
<b>1.3. Shpronësim</b>	<b>300,000,000</b>
<b>1.4. Projektim dhe mbikëqyrje</b>	<b>618,000,000</b>
<b>1.5. Pajisje dhe softuer</b>	<b>6,000,000</b>
<b>1.6. Fonde buxhetore për prokurimin e mekanizimit për mirëmbajtjen e NP-së për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale me Vendim të Qeverisë</b>	<b>180,000,000</b>
<b>2. INVESTIME NGA KREDI TË HUAJA</b>	<b>12,538,500,000</b>
<b>2.1. Kredi nga Banka Botërore</b>	<b>754,000,000</b>
2.1.1. Projekt për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve	754,000,000
<b>2.2. Kreditë nga BERZH-i</b>	<b>8,784,500,000</b>
2.2.1. Sistemi elektronik i pagesës së taksës rrugore Korridorin 10	123,000,000
2.2.2. Projekt për ndërtimin e rrugëve nacionale	4,369,500,000
2.2.3. Projekti për Shtip-Radovish, ndërtim të rrugës së shpejtë	1,342,000,000
2.2.4 Projekt për rindërtimin dhe rehabilitimin e segmentit Kriva Pallankë- Deve Bair (kufiri me R. e Bullgarisë)	400,000,000
2.2.5 Projekt për taksë rrugore në Korridorin 8	600,000,000
2.2.6 Bukojçan-Kërçovë	900,000,000
2.2.7 Shkup- Bllacë	1,050,000,000
<b>2.3. Kredi nga Banka Eksim</b>	<b>3,000,000,000</b>
2.4.1 Projekt për ndërtimin e autostradës Kërçovë- Ohër	3,000,000,000

- Ilustrim grafik i shpenzimeve të planifikuara, shlyerjes së kredive dhe investimeve në vitin 2021



**II.1. Në vitin 2021 planifikohen shpenzime prej 2.451.000.000 denarëve për:**

II.1.1 Për shpenzime të materialit shpenzues për zyra, inventar të imët dhe karburant janë planifikuar gjithsej **20,000,000 denarë**. Këto shpenzime janë për: tonerë për printerë dhe fotokopjues, letër kase fiskale në stacionet pagesore, mandat arkëtimi, letër për fotokopje, karburant për gjenerator rryme dhe automjete zyrtare, pajisjet MHT për punonjësit e stacioneve pagesore, preparate higjienike dhe shpenzime të tjera.

II.1.2 Për shërbime të mirëmbajtjes së rrugëve, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjeve, shërbimet komunale dhe shërbimet e tjera, janë planifikuar gjithsej **1,452,000,000 denarë**. Shumica e këtyre mjeteve janë planifikuar për mirëmbajtjen e rrugëve, nëpërmjet marrëveshjes me Ndërmarrjen Publike të Mirëmbajtjes dhe të Mbrojtjes së Rrugëve

Magjistrale dhe Rajonale. Përveç mirëmbajtjes së rrugëve, në këtë zë hyjnë edhe shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesave, të objekteve, softuerëve dhe pajisjeve (ashensorë, fotokopjues dhe printerë, kondicionerë, automjete, gjeneratorë, central KZ, aparate KZ dhe testim të instalimit kundër rrufesë, shtypës fiskalë, sistem për vëzhgim video dhe pajisje komunikimi të SP dhe kalimet kufitare, sistemi i pagesës së pikave pagesore, etj), shërbime komunale, shërbime higjienike, energji elektrike, provizion për shoqatat e inspektimit teknik, avokat, noter, shpenzimet e përmbauesve dhe shërbime të tjera.

II.1.3 Për paga dhe kompensime të tjera për punonjësit (të përcaktuara me ligj, akte nënligjore, marrëveshje kolektive, akte të ndërmarrjes, etj) janë planifikuar gjithsej **300,000,000 denarë**. Këto mjete sigurohen për pagimin e pagës bruto dhe kompensimeve të ndryshme për punonjësit.

II.1.4 Për transferim në NJVL-të për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave, janë planifikuar mjete prej **300,000,000 denarë**. Sipas Ligjit të Rrugëve Publike mjetet transferohen te Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale pas Programit të dorëzuar për vitin aktual dhe Raportit për funksionimin e vitit paraprak.

II.1.5 Për pagimin e tatimeve, kthimin e mjete nga regjistrimi, provizionet bankare dhe shpenzimet e tjera operative janë planifikuar **379.000.000 denarë**. Ky grup përfshin: Tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimin e mjeteve nga regjistrimi i automjeteve motorike dhe rimorkiove që kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave, provizione bankare, si dhe shpenzime të tjera që dalin nga puna ditore (sigurimi i punonjësve dhe pronës, transporti i punonjësve, kontrolli sistematik, transferimi i shpejtë i dërgesave, kompensime për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës, etj.)

II.1.6 Ilustrim grafik i shpenzimeve vetjake në shpenzimet e përgjithshme të planifikuara për vitin 2021



II.2 Për shlyerjen e kredive të institucioneve ndërkombëtare financiare, janë planifikuar mjete në vlerë prej 4,550,000,000 denarë, ose për:

II.2.1. Për shlyerjen e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, parashihen mjete prej 830,000,000 denarëve.

II.2.2. Në bazë të shlyerjes së kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, janë planifikuar mjete në vlerë prej 3,720,000,000 denarëve.

### II.3. PROGRAMI I INVESTIMEVE

Ndërmarrja Publike në vitin 2021 planifikon të realizojë fonde për investime në vlerë totale prej 16.010.500.000 denarësh, edhe atë:

II.3.1 Për investime me mjete individuale dhe buxhetore parashihen 3,472,000,000 denarë.

II.3.1.1 Për ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin, rindërtimin, ndriçimin, sinjalizimin, pajisjet rrugore, urat, tunelet, rrëshqitjet e tokës, për pjesëmarrjen personale në investime të financuara nga kreditorë të huaj dhe punime të tjera janë planifikuar 1,642,000,000 denarë.

Këto fonde sigurohen për realizimin e projekteve të mëposhtme:

- Projekte të përfunduara, ndërsa pagesa do të ketë në vitin 2021:
  - Ndërtim shtesë të rrugës rajonale nga Shkupi deri Qytetin e Diellit,
  - Rehabilitimi i rrugës shtetërore R1205 - Zletovë - Probishtip,
  - Rindërtimi i rrugës rajonale R2133 segmenti Mateç - Likovë,
  - Ndërtim shtesë i rrugës rajonale të aksit 1 të R-418 (faza 2), në lëvizje fabrika "Vevçanka" - Shtëpia e Shëndetit Vevçan,
  - Ndërtimi i rrugës shtetërore R1402 segmenti F. Konjarevë - L. Konjarevë,
  - Rehabilitimi i rrugëve shtetërore: R1302, segmenti Strumicë - Berovë dhe segmenti A4, Strumicë - Novo Sellë
  
- Projektet që do të vazhdojnë me realizimin në vitin 2021:
  - Ndërtimi i urës nr. 5, l. Lluda Mara në rrugën shtetërore R1107,
  - Ndërtimi i urës nr. 2, l. Babuna, Bogomilë në rrugën shtetërore R2336,
  - Ndërtimi i urës në rrugën shtetërore R2136 në l. Pçinja afër Konjares

- Pyllëzimi i shpateve për mbrojtje nga erozioni në magjistralen Milladinoc - Shtip,
- Rehabilitimi i urës nr. 1 Llakavicë,
- Kompletimi i punimeve të papërfunduara për ndërtimin e autostradës A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip,
- Rehabilitimi i rrugës shtetërore A3, transit nëpër Ohër,
- Ndërtimi i gardhit mbrojtës në Qarkoren e Manastirit,
- Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, segmenti Kumanovë - Stracin (faza 2),
- Ndërtimi i autostradës A4, segmenti PN "Bllacë" - Shkup (nyja rrugore "Stenkovec"), nënsegmenti 1 - zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PN "Bllacë" deri në fshat. Bllacë në nivelin e autostradës dhe ndërtimin e një pjese të autostradës me nyje rrugore për lidhje me rrugë lokale për në fshat. Bllacë,
- Rehabilitim i rrëshqitjes së tokës në segmentin R2249 Melniçan - Gorencë (Qendra Zhupë),
- Rehabilitimi i rrëshqitjes së tokës dhe mureve mbajtëse në R1202, afër Jançes dhe Skudrinjes
- rehabilitimi i rrëshqitjes së tokës në rrugën rajonale R1308, Pretor - Markova Nogë,
- Riparimi dhe rehabilitimi i rrugës shtetërore R29273, segmenti Botun (lidhje me A2) - Belçishtë - Brezhan,
- Punimet ndërtimore të rehabilitimit në urën nr. 1 në R2244 mbi lumin Pçinjë afër fshatit Dragomanc
- Punimet ndërtimore të rehabilitimit në urën nr. 3 në R1103 (Llakavicë - Negotinë)
- Ndërtimi i murit mbajtës prej betoni të armuar në rrugën shtetërore R2133, Mateç - Likovë,
- Instalimi i pajisjeve rrugore nëpër taksat rrugore për të përmirësuar sigurinë në trafik

- Rehabilitim i rrëshqitjes së tokës në R1306, segmenti Krushevë - Sladuevë,
  - Dhe projekte të tjera
- Projektet që do të fillojnë në vitin 2021:
    - Rindërtim dhe rehabilitimi i rrugës shtetërore R1109 (qarkorja në Bogdanc),
    - Rindërtimi i rrugës shtetërore R2133 segmenti Ropalcë - Mateç,
    - Rindërtim me rehabilitimin e rrugës shtetërore R1203, segmenti Tetovë - Xhepçishtë,
    - Ndërtimi i rrugës rajonale, segmenti R2246, Izvor (kryqëzim me A2) - Ura e Garit;
    - Rindërtimi dhe rehabilitimi i rrugës rajonale R2235, segmenti Nikiforovë - Leunovë - Bunec (kryqëzimi me R1202),
    - Ndërtimi i një ure të re në lumin Pçinjë për lidhjen e autostradës së ardhshme A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip (qarkorja Konjarë i Mesëm) me rrugën rajonale R2136
    - Dhe projekte të tjera
- Nëse sigurohen fonde në vitin 2021, planifikohet të fillojnë projektet e mëposhtme:
    - Instalimi i gardhit mbrojtës akustik në pjesë të caktuara të autostradës përgjatë korridoreve 8 dhe 10 (afër qytetit të Kumanovës dhe afër vendbanimit Saraj),
    - Instalimi i sinjalizimit të trafikut dhe pajisjeve në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër,
    - Ndërtimi i rrugës ekspres Manastir – Mexhitli,

- Ndërtim i rrugëve shtetërore të mëposhtme sipas kushteve të kontratës FIDIK (Libri i Verdhë) Projektim dhe ndërtim:
- Ndërtim i autostradës Prilep – Manastir;
- Ndërtim i autostradës Tetovë – Gostivar;
- Ndërtim i autostradës Gostivar -Bukojçan;
- Ndërtimi i autostradës Trebenishtë - Strugë – Qafë Thanë, në përputhje me vërejtjet e UNESCO-s, nëse UNESCO jep mendim pozitiv dhe
- Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, Qarkorja e Kriva Pallankës.

II.3.1.2 Për mirëmbajtjen investuese të rrugëve parashihen 726.000.000 denarë. Shumica e këtyre fondeve do të realizohen përmes Marrëveshjes me Ndërmarrjen Publike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale, të parashikuara në Programin Vjetor për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2021;

II.3.1.3 Për shpronësim të tokës, ndërtesave, pyjeve, plantacioneve dhe të mbjellave të segmentit që planifikohen për ndërtim gjatë vitit 2021, janë planifikuar 300.000.000 denarë;

II.3.1.4 Për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit në rrugët shtetërore, parashihen fonde në vlerë prej 618.000.000 denarë. Ky pozicion mbulon kostot për përgatitjen e studimeve fizibiliteti, projekteve të infrastrukturës, studimeve të mjedisit jetësor, projekteve themelore dhe pjesëve të tjera të dokumentacionit tekniko-



investues, siç është mbikëqyrja mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

Në vitin 2021, planifikohet pagesa e kontratave tashmë të lidhura për përgatitjen e dokumentacionit projektues për segmentet e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për segmentin e rrugës ekspres Manastir - Mexhitli me qarkoren e Manastirit,
- Përgatitja e projektit themelor për rrugën shtetërore A2 segmenti Bukojçan - Kërçovë,
- Përgatitja e projektit të infrastrukturës për rrugën shtetërore A2, segmenti Bukojçan - Kërçovë (varianti me tunel),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rindërtimin e segmentit Strumicë - Dabile,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues segmenti Strumicë - Vallandovë - lidhja me A1,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e mureve mbajtës në rrugën R1202, afër fshatit Jançe dhe fshatit Skudrinjë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitim me përmirësime të autostradës A1, PN Tabanoc - lidhja Tabanoc,
- Ndryshimi dhe plotësimi i projektit të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës rajonale R2138, lidhja me rrugën rajonale R2134, me lagjen Qyteti i Diellit,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues në rrugën shtetërore A3 qarkorja Resnjë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për instalimin e sinjalizimit të trafikut dhe pajisjeve në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër,

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e segmenteve rrugore Hipodrom - Milladinoc, Milladinoc - Petrovec dhe Petrovec - Hipodrom,
- Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacionit projektues lidhjen e autostradës së ardhshme A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip (lidhja Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugëve shtetërore të financuara nga BERZH-i (faza I)
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugëve shtetërore të financuara nga BERZH-i (faza II)
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rindërtimin dhe rehabilitimin e rrugës shtetërore R1109,
- Kompletimi i dokumentacionit ekzistues të projektit dhe përgatitja e një projekti infrastrukturor për rindërtimin duke zgjeruar rrugën rajonale R2236 segmenti Shën Nikollë - Neokaz,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrëshqitjes së tokës në R1306, segmenti Krushevë - Sladuevë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rindërtimin duke zgjeruar rrugën rajonale R1109 segmenti Ponov Most - hyrja në Bogdanc,

Në vitin 2021 planifikohet përgatitja e dokumentacionit projektues për segmente të reja:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin dhe rehabilitimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Negotinë - TEC Negotinë (të dy korsitë),

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për mbrojtjen e shpateve për autostradën A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për përfundimin e qarkores së Bogdancit që është pjesë e rrugës shtetërore R1109,
- Përgatitja e projektit urbanistik për rindërtimin dhe rehabilitimin e rrugës rajonale R2235, segmenti Nikiforovë - Leunovë - Bunec (kryqëzimi me R1202),
- Përgatitja e një studimi të fizibilitetit bazuar në një projekt ideor, në përputhje me rregullat e FIDIK dhe përgatitja e dokumentacionit të tenderit për ndërtim sipas FIDIK (Libri i Verdhtë) për seksionet vijuese të autostradës:  
Manastir – Prilep  
Tetovë - Gostivar – Bukojçan  
Ohër (Trebenisht) – Strugë – Qafë Thanë në përputhje me vërejtjet e UNESCO-s, nëse UNESCO jep mendim pozitiv
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e qarkores në Tetovë nëpërmjet lidhjes Trebosh deri në Neproshten,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për lidhjen e Tetovës me Prizrenin (Kosovë) në nivelin e projektit ideor,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për autostradën A2, segmenti Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për zgjerimin dhe përmirësimin e elementeve gjeometrike në rrugën shtetërore R2234, segmenti Kondovë - Radushë - Jegunovcë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugës shtetërore A1, segmenti lidhës Gjevgjeli - PN Bogorodicë (korsia e djathtë),

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugës shtetërore R1212, segmenti Ohër - Shën Naum
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rrugën e shpejtë, segmenti Strumicë - kufiri me R. Bullgarisë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për autostradën Prilep - Manastir dhe Tetovë - Gostivar (grant fonde nga IPA 3)
- dhe projekte të tjera

Nëse sigurohen fonde në vitin 2021, planifikohet të fillojnë projektet e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për kryqëzimin e autostradës A2, segmenti Kriva Pallanka - me autostradën ekzistuese,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin dhe rehabilitimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Stobi - Gratsko (të dy korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugës shtetërore A2, Qarkorja e Kriva Pallankës,
- dhe projekte të tjera

**II.3.1.5** Për prokurimin e pajisjeve dhe softuerëve janë planifikuar **6,000,000 denarë.**

**II.3.1.6** Fondet e aprovuara në vlerë prej 180,000,000 denarë në përputhje me Vendimin për aprovimin e fondeve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 nr. 11754/13 datë 11.12.2020 dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për aprovim të fondeve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 nr. 444-12415/2 datë 22.12.2020 destinohen posaçërisht për prokurimin e mekanizimit për mirëmbajtjen e standardeve

minimale të infrastrukturës në përputhje me Kërkesën nr. 10-2034/1 datë 04.12.2020 të NP për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale.

II.3.2 Për investime nga kreditë e huaja parashihen 12,538,500,000 denarë, edhe atë të financuar nga: Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Eksim.

II.3.2.1 Kredi nga Banka Botërore në vlerë prej 754,000,000 denarë, për projektet e mëposhtme:

- Me Projektin për avancimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Banka Botërore, do të financohet:
  - Ndërtimi i rrugës së shpejtë Rankovcë - Kriva Pallankë,
  - Shërbime konsultimi: Asistenca e NPRRSH për Aktivitetet përgatitore për vendosjen e sistemit të menaxhimit me ura
  - Shërbime konsultimi: Ex-ante dhe Ex-post hulumtim dhe vlerësim përdorues dhe vlerësimi i ndikimit
  - Përzgjedhja e konsultuesit për vendosjen e një sistemi të menaxhimit të urave në rrjetin rrugor,
  - Përzgjedhja e konsultuesit për revizion teknik gjatë ndërtimit të autostradës Rankovcë - Kriva Pallankë,
  - Prokurimi i harduerit dhe softuerit për vendosjen e një sistemi të menaxhimit me urat në rrjetin rrugor,
  - Pajisje për mbikëqyrjen e urave në rrjetin rrugor
  - Dhe projekte të tjera

II.3.2.2 Kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 8,784,500,000 denarë, për projektet e mëposhtme:


- **Projekti Korridor 10 – taksat rrugore, për vendosjen e sistemit elektronik të pagesës së taksave në Korridorin 10 dhe ndërtimin e stacioneve të reja pagesore në segmentet e sapo ndërtuara të autostradës.**
  
- **Me Projektin Program për rrugët nacionale, do të financohen:**
  - Ndërtimi i rrugës së shpejtë Shtip - Koçan (Segmenti Shtip - Krupishtë dhe Segmenti Krupishtë - Koçan),
  
  - Ndërtimi i autostradës Gradsko - Prilep, segmenti (Farish - Drenovë),
  
  - Aplikimi i arkivit digjital,
  
  - Rehabilitimi i më shumë rrugëve shtetërore: Probishtip - Krupishtë, Katlanovë - Petrovec (2 kors), Hanet e Mavrovës - Zhirovnice, Gryka e Farishkës - Prilep, Karpallëk - Zhelinë, Makedonska Kamenicë - Sasë, Kërçovë - Makedonski Brod dhe Uzem - Toranicë.
  
  - Rehabilitimi i 7 rrugëve (faza 5): Shkup - Bllacë, Krivogashtan - Krushevë, Podmolje - Strugë - Qafë Thanë, Manastir - Mexhitlijë, Manastir - Demir Hisar, Krushevë - Demir Hisar dhe Drugovë - Demir Hisar
  
  - Rehabilitimi i 5 rrugëve (faza 6): Milladinoc - Petrovec, Hipodrom - Petrovec, Milladinoc - Hipodrom, Katlanovë - Veles, Veles - Gradsko
  
  - dhe projekte të tjera

- Me Projektin segmenti rrugor Shtip - Radovish, do të financohet ndërtimi i rrugës së shpejtë Shtip - Radovish
- Me Projektin Kriva Pallankë - Deve Bair, do të financohet rindërtimi dhe rehabilitimi i aksit rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair
- Projekti i taksave rrugore në autostrada, do të financohet për vendosjen e sistemit elektronik të pagesës së taksave rrugore në Korridorin 8 dhe ndërtimin e stacioneve të reja pagesore në segmentet e sapo ndërtuara të autostradës.
- Ndërtimi i autostradës Bukojçan - Kërçovë, me grant fonde të siguruar nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
- Ndërtimi i autostradës Shkup - Bllacë, me grant fonde të siguruar nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

#### **II.3.2.4 Kredi nga Eksim Bank në vlerë prej 3,000,000,000 denarë, për financim të:**

- Ndërtimit të autostradës Kërçovë - Ohër

#### **II.3.3 Ilustrim grafik të investimeve të planifikuara në vitin 2021**



### III.

Ky Program hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, ndërkaq do të fillojë të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KËSHILLI DREJTUES I NP-së TË RRUGËVE  
SHTETËRORE

KRYETAR

ЉУПКА ЦИКАРСКА

